FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 76

Tiranë – E premte, 21 maj 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 19.5.2021	Për miratimin e tekstit të marrëveshjes së furnizimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin e Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar *"Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret A.Ş."*.....	8305
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 19.5.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës", të ndryshuar.....	8305
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 287, datë 19.5.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", të ndryshuar.....	8312
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 289, datë 19.5.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 95, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat për vlerësimin e kërcënimit të rrezikut për jetën dhe pajisjen me autorizim të posaçëm për mbajtje arme", të ndryshuar.....	8312
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 291, datë 19.5.2021	Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2021, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për financimin e projektit "Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit".....	8313
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 299, datë 19.5.2021	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Gerond Husi.....	8314

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 300, datë 19.5.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 20, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021".....	8314
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 71/5, datë 18.5.2021	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti *"Zgjerimi territorial i varrezave të qytetit të Durrësit"*.....	8316

AKT NORMATIV
Nr. 21, datë 19.5.2021

PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË MARRËVESHJES SË FURNIZIMIT NDËRMJET MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN E INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR *"KEYMEN ILAÇ SANAYI VE TICARET A.Ş."*

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i tekstit të marrëveshjes

1. Miratimin e tekstit të marrëveshjes së furnizimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin e Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar *"Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret" A.Ş.,* sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

2. Marrëveshja për furnizimin ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtim e Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar *"Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret" A.Ş.,* për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së shprehur në marrëveshje nga *"Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret"*, nuk do të publikohet në asnjë *website* të institucioneve apo në Fletoren Zyrtare.

3. Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, të miratimit apo që janë pjesë e procesit kanë detyrimin të mos bëjnë publike marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.

4. Detyrimet e organeve shtetërore dhe përjashtimet nga detyrimet për furnizimin e vaksinës anticovid, të përcaktuara në aktin normativ nr. 1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të njëjta edhe për këtë marrëveshje, sipas kushteve të tekstit të saj, bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2
Efektet financiare

Efektet financiare, që rrjedhin nga marrëveshja bashkëlidhur këtij akti normativ, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 286, datë 19.5.2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT MJEKËSOR, TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE, NË SISTEMIN E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, NË STRUKTURAT E TJERA TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE SPITALIN PËRKATËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) Në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, pas fjalëve " ... në strukturat shëndetësore universitare ... " shtohen fjalët " ... në spitalet e nivelit terciar ...".

b) Lidhja 1/AP, që përmendet në shkronjën "a", të pikës 2, dhe kreu 1/1, që përmendet në shkronjën "b", të pikës 2, zëvendësohen përkatësisht me lidhjen 1/AP "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga "specialist" deri në "titullar institucioni" në struktura shëndetësore universitare, në spitalet e nivelit terciar, në spitalet rajonale, spitalet psikiatrike dhe spitalet bashkiake" dhe kreun 1/1 "Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare, në spitalet e nivelit terciar dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës", që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

c) Kreu 2.1, i lidhjes nr. 2, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër dhe me titull "Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në strukturat shëndetësore universitare e në spitalet e nivelit terciar dhe personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Në pikën 13, pas fjalëve "... kërkimore-shkencore ..." shtohen fjalët " ... si dhe në spitalin rajonal "Memorial" Fier ...".

d) Pas pikës 19 shtohet pika 20, me këtë përmbajtje:

"20. Për një periudhë tranzitore (3-vjeçare) të funksionimit të spitalit rajonal "Memorial" në Fier, në bashkëpunim me personat e caktuar nga Ministria e Shëndetësisë Turke, pagat e punonjësve turq, të personelit të administrimit të përgjithshëm, të personelit mjekësor dhe të personelit teknik të shkencave mjekësore, të jenë të njëjta me pagat e çdo pozicioni respektiv pune, sipas lidhjes nr. 1/AP, lidhjes nr. 1 (kreu 1.1) dhe lidhjes nr. 2 (kreu 2.1) të këtij vendimi.

Përveç pagës, sipas lidhjeve përkatëse si më sipër, punonjësit turq të personelit të administrimit të përgjithshëm, të personelit mjekësor dhe të personelit teknik të shkencave mjekësore do të përfitojnë edhe një shpërblim mujor, në masën e përcaktuar në lidhjen nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2021, për spitalin rajonal "Memorial" në Fier, përballohen nga fondet e miratuara për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe fillojnë nga data e emërimit të punonjësve në detyrë.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1 (lidhja 1/ap)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga "specialist" deri në "titullar institucioni" në struktura shëndetësore universitare, në spitalet e nivelit terciar, në spitalet rajonale, spitalet psikiatrike dhe spitalet bashkiake

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Titullar institucioni në QSU "Nënë Tereza" Titullar institucioni në spitalin rajonal "Memorial" Fier	1	2%	0	118.600	25.000
2	Titullar institucioni në: - Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" Tiranë - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr. 1 dhe nr. 2 Tiranë - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë	1	2%	0	118.600	15.000
3	Titullar institucioni në: - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut - Zëvendëstitullar institucioni në QSU "Nënë Tereza" - Zëvendëstitullar institucioni në spitalin rajonal "Memorial" Fier	1	2%	0	110.000	15.000
4	Titullar institucioni në spitalet rajonale Titullar institucioni në spitalet psikiatrike Zëvendëstitullar institucioni në: - Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" Tiranë - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr. 1, nr. 2 Tiranë - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut	1	2%	0	97.000	
5	Titullar institucioni në spitalet bashkiake	1	2%	0	95.000	
6	Zëvendëstitullar institucioni në spitalet rajonale/psikiatrike/bashkiake	1	2%	0	82.000	
7	Drejtor drejtorie në QSU "Nënë Tereza" Drejtor drejtorie në spitalin rajonal "Memorial" Fier	1	2%	0	82.000	
8	Përgjegjës sektori biomedikal	1	2%	0	74.000	
9	Administrator për polin e administrimit të integruar në QSU "Nënë Tereza"	1	2%	0	65.000	
10	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes në spitalet universitare dhe në QKTGJ Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes në spitalin rajonal "Memorial" Fier	1	2%	0	61.000	
11	Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në spitalet universitare Përgjegjës sektori Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut Përgjegjës sektori në Klinikën Stomatologjike Universitare	1	2%	0	59.000	

	Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në spitalin rajonal "Memorial" Fier					
12	Përgjegjës sektori në spitalet rajonale dhe psikiatrike	1	2%	0	49.000	
13	Specialist/inxhinier biomedikal në spitalet universitare, në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe në spitalin rajonal "Memorial" Fier	1	2%	0	61.000	
14	Përgjegjës sektori në spitalet bashkiake Specialist/inxhinier biomedikal në spitalet rajonale, psikiatrike dhe bashkiake	1	2%	0	49.000	
15	Specialist auditi/Specialist në QSU "Nënë Tereza" dhe në spitalin rajonal "Memorial" Fier	1 ose 2, ose 3	2%	0	43.000	
16	Specialist auditi/Specialist në: - Spitalet universitare - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut	1 ose 2, ose 3	2%	0	40.000	
17	Specialist auditi/specialist në spitalet rajonale dhe psikiatrike	1 ose 2, ose 3	2%	0	38.000	
18	Specialist në spitalet bashkiake	1 ose 2, ose 3	2%	0	34.200	

Lidhja nr. 1 (kreu 1.1)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare, në spitalet e nivelit terciar dhe në njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës

	EMËRTIMI	**PAGA MUJORE**				
		Paga e grupit (PG)	**Shtesa për vjetërsi (SHV)**	**Shtesa për kualifikim (SHK)**	**Shtesa për pozicion (SHP)**	**Shtesa për kushte pune (SHKP)**
		1	**2**	**3**	**4**	**5**
1	Shef Shërbimi infektiv në QSUNT Shef Shërbimi infektiv në spitalin rajonal "Memorial" Fier	1	2%	0	103.600	8000
2	Shef shërbimi	1	2%	0	103.600	
3	Shef reparti infektiv në QSUNT Shef reparti infektiv në spitalin rajonal "Memorial" Fier	1	2%	0	90.300	8000
4	Shef reparti/klinike (kirurgji, urgjencë etj.) Shef i Qendrës së Gruas Shef njësie në QSUNT Shef njësie në spitalin rajonal "Memorial" Fier	1	2%	0	90.300	
5	Shef reparti/klinike reanimacioni	1	2%	0	90.300	1100
6	Shef reparti/klinike psikiatrie	1	2%	0	90.300	5000
7	Shef i Laboratorit Klinik Biokimik Shef reparti kimioterapi Shef laboratori Shef i Qendrës së Diagnozës Molekulare	1	2%	0	90.300	2200
8	Shef Reparti i Rrezatimit	1	2%	0	90.300	4600
9	Shef sektori mjekësor Shef farmacie	1	2%		82.460	

10	Përgjegjës i Sektorit të Laboratorëve/shef i Bankës së Gjakut/shef i Sektorit të Mbledhjes dhe i Përpunimit të Gjakut në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut	1	2%	0	82.460	2500
11	Mjek Stomatolog Biolog, kimist, fizikant në preparatori. Mikrobiolog, parazitolog, virolog, mykolog Përgjegjës qendre DDD Përgjegjës njësie në QSUNT Specialist fizkulture (fizioterapi neurologji)	1	2%	0	79.800	
12	Mjek/biokimist/biolog në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut	1	2%	0	79.800	1600
13	Mjek infeksionist në QSUNT Mjek infeksionist në spitalin rajonal "Memorial" Fier	1	2%	0	79.800	8000
14	Mjek kirurg (specialitete kirurgjikale) Mjek onkolog Mjek fizioeterapevt Mjek obsteter gjinekolog Mjek pneumoftiziatër	1	2%	0	79.800	1100
15	Mjek radilolog Toksikolog, alkolog, kimist, në laboratorin toksikologjik Kimist në laboratorin biokimik Fizikant në laboratorin biokimik Biolog në laboratorin biokimik	1	2%	0	79.800	1600
16	Mjek radiolog, në shërbimin infektiv në QSUNT dhe në shërbimin infektiv në spitalin rajonal "Memorial" Fier Mjek në kabinetin e ekografisë, në Shërbimin Infektiv në QSUNT dhe në kabinetin e ekografisë në spitalin rajonal "Memorial" Fier	1	2%	0	79.800	8000
17	Mjek kimioterapeut Mjek hematolog Mjek infeksionist Mjek në pranim urgjence Mjek në njësinë nozokomiale Mjek laboratori Mjek histopatolog Mjek në shërbimin e gjakut	1	2%	0	79.800	2000
18	Mjek në Inspektoratin Sanitar Inspektor sanitar Farmacist	1	2%	0	79.800	2500
19	Farmacist në Laboratorin Toksikologjik Mjek në hemodinamikë	1	2%	0	79.800	2800
20	Mjek anatomopatolog Mjek anestezist, reanimator Mjek në pavijonin e rrezatimit Specialist në qendrën e diagnozës molekulare Mjek pediatër neonatolog Fizikant kobalti	1	2%	0	79.800	3700
21	Mjek, psikolog, punonjës social që punojnë në psikiatri	1	2%	0	79.800	5000

Lidhja nr. 2 (kreu 2.1)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore, në strukturat shëndetësore universitare e në spitalet e nivelit terciar dhe personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermier Shërbimi Psikiatrik		2%	0	56.000	6000
2	Kryeinfermier shërbimi në shërbimin infektiv në QSUNT Kryeinfermier shërbimi në shërbimin infektiv në spitalin rajonal "Memorial" Fier. Kryeinfermier/kryemami e përgjithshme		2%	0	56.000	8000
3	Kryelaborant në Shërbimin e Anatomisë Patologjike Kryeinfermier Shërbimi i Terapisë Intensive Kryeinfermier Shërbimi Onkologjik Kryelaborant Rrezatim Kobalti Kryelaborant në Histopatologji Kryeinfermierë të Repartit të Rrezatimit		2%	0	56.000	3400
4	Kryeinfermier reparti/njësi psikiatrike		2%	0	56.000	5000
5	Kryeinfermier Reparti në Shërbimin Infektiv në QSUNT Kryeinfermier reparti në shërbimin infektiv në spitalin rajonal "Memorial" Fier		2%	0	56.000	8000
6	Kryeinfermier shërbimi Neurokirurgji Kryeinfermier/kryemami reparti i Terapisë Intensive/Stroke dhe Post stroke Kryeinfermier në Hemodinamikë		2%	0	56.000	2600
7	Kryeinfermier kimioterapi Kryelaborant klinik biokimik Kryeinfermier në urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme Kryeinfermier/mami salle Kryeinfermier/mami e dhomës së zgjimit Infermier në hemodinamikë Kryelaborant imunolog, bakteriolog		2%	0	56.000	1800
8	Kryeinfermier shërbimi (kirurgji, neurologji, djegie plastike, kardiokirurgji, maksilofacial, infektiv, pediatrik infektive, obsetrik) Kryeinfermier/kryemami në Repartin e Kirurgjisë Kryemami turni në kirurgji/në obsetrikë Kryeinfermier Reparti Infektiv Kryeinfermier reparti (fizioterapi, urologji, urgjencës së neurologjisë, neurokirurgji, onkologji) Kryeinfermier/kryemami salle operacioni		2%	0	56.000	1100
9	Kryeinfermier shërbimi Kryelaborant shërbimi Kryemami shërbimi Kryeinfermier/kryelaborant në QKTGJ		2%	0	56.000	
10	Infermier/laborant në psikiatri		2%	0	53.200	5000
11	Laborant histopatolog		2%	0	53.200	3400

12	Infermier/mami reanimacioni, neonatologji Infermier në dhomën e zgjimit		2%	0	53.200	2650
13	Infermier në kimioterapi		2%	0	53.200	1800
14	Kryelaborant imazherie		2%	0	53.200	1500
15	Specialist i Sektorit të Kujdesit Infermieror		2%	0	53.200	1100
16	Kryeinfermier në repartin e alergologjisë		2%	0	53.200	
17	Laborant radiolog në onkologji		2%	0	47.000	3700
18	Laborant rrezatim kobalti		2%	0	47.000	3400
19	Laborant në mjekësinë bërthamore		2%	0	47.000	2650
20	Infermier në Njësinë e Inspektoratit Sanitar dhe Infeksioneve Nazokomiale Infermier/mami në sallën e operacionit		2%	0	47.000	2100
21	Kryeinfermier reparti pranim urgjence Laborant klinik biokimik Infermier në punktin e gjakut Infermier në hematologji Infermier në onkologji Infermiere endoskopie Infermier/laborant bakterilog, imunolog		2%	0	47.000	1800
22	Infermier reparti radiologjik/angio CT Teknik imazherie dhe angio CT Laborant radiolog Kryeinfermier (pranim urgjence, djegie plastike, kirurgji) Kryemami në qendrën e gruas		2%	0	47.000	1500
23	Infermier/mami (kirurgji, maksilofaciale, neurokirurgji, kardiokirurgji, djegie plastike, obsetrike, gjinekologji/patologji barre/neonatologji) Infermier salle Infermier/laborant në QKTGJ		2%	0	47.000	1100
24	Kryeinfermier neonatologji Kryemami pranimi Kryeinfermier në kabinetin e dializës Kryemami/kryeinfermier reparti/klinik/turni Kryeinfermier konsultash në sëmundjet e brendshme Kryelaborant bakteriolog, imunolog, ortopedi stomatologjike)		2%	0	47.000	
25	Infermier pavijoni rrezatimi		2%	0	45.000	3310
26	Infermier në shërbimin infektiv në QSUNT Infermier në shërbimin infektiv në spitalin rajonal "Memorial" Fier		2%	0	45.000	8000
27	Infermier pranim urgjence (njësia e koordinimit të urgjencës)		2%	0	45.000	1800
28	Infermier në hemodializë		2%	0	45.000	1500
29	Infermier fizioterapi		2%	0	45.000	1100
30	Laborant (ezhe, ortopedi, stomatologji) Infermier Mami Logopedi Infermier çerdheje për personelin Kujdestar Prozektor		2%	0	45.000	
31	Kujdestar në psikiatri		2%	0	39.550	5000

Lidhja nr. 10

Shpërblimi për punonjësit e personelit të caktuar nga pala turke në spitalin rajonal "Memorial" Fier

	Emërtimi i pozicionit	Masa mujore e shpërblimit, në lek
1	Nëndrejtor (teknik)	266,000
2	Nëndrejtor (administrativ)	161,000
6	Shef shërbimi	285,000
4	Mjeke te specialiteteve te ndryshme	305,000
5	Farmacist	142,000
6	Kryeinfermier i përgjithshëm	227,000
7	Infermier	181,000
8	Përgjegjës sektori	104,000
9	Specialist	120,000
10	Teknik biomedikal	102,000

VENDIM
Nr. 287, datë 19.5.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 710, DATË 21.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMEVE TË RUAJTJES SË INFORMACIONIT, VAZHDUESHMËRISË SË PUNËS DHE MARRËVESHJEVE TË NIVELIT TË SHËRBIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", dhe të pikës 3, të nenit 21, të ligjit nr. 10273, datë 29.4.2010. "Për dokumentin elektronik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën "a", të pikës 2, të vendimit nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët "… jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.", zëvendësohen me "… jo më e shkurtër se 2 (dy) vjet.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 289, datë 19.5.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 95, DATË 4.2.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E KËRCËNIMIT TË RREZIKUT PËR JETËN DHE PAJISJEN ME AUTORIZIM TË POSAÇËM PËR MBAJTJE ARME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 95, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja "a", e pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Kërkesa e personit, që kërcënohet për shkak të aktivitetit shtetëror ose rrethanave personale të veçanta për pajisjen me autorizim të posaçëm për mbajtje arme, e cila bëhet *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania* dhe duhet të përmbajë:

- gjenealitetet e plota të personit (emër, atësi, mbiemër, datëlindje);
- adresën e banimit;
- numrin e kontaktit;
- arsyen për të cilën kërkon të pajiset me autorizim të posaçëm;".

2. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

"4/1 Në zbatim të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", të ndryshuar, personi, përveç dokumenteve të dorëzuara *online*, duhet të kryejë paraprakisht procedurat përkatëse për të siguruar dhe dorëzuar fizikisht dhe origjinale në komisariatin e policisë ku ka vendbanimin, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i plotësimit *online* të kërkesës, edhe dokumentet e mëposhtme:

- raportin mjeko-ligjor lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

- dëshminë e aftësimit teorik-praktik për përdorimin e armës.".

3. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Këto dokumente, të administruara në komisariatin e policisë, brenda 5 (pesë) ditëve pune, dërgohen për t'u regjistruar në drejtorinë vendore të policisë, e cila, pasi bën vlerësimin dhe shpreh mendimin mbi dokumentacionin e dërguar nga komisariati i policisë, e përcjell atë për shqyrtim në Komisionin Qendror në Policinë e Shtetit.".

4. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Rrethana personale të veçanta konsiderohen ato kur, për shkak të detyrës, rrethanave të rastit ose flagrancës, personi ka dijeni për kryerjen e veprës penale, është lehtësisht i identifikueshëm nga autorët e veprës penale dhe për këtë shkak i rrezikohet jeta.".

5. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Komisioni shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga drejtoria vendore/rajonale e policisë ku ka vendbanimin personi i kërcënuar për shkak të aktivitetit shtetëror ose rrethanave personale të veçanta dhe merr vendim për lëshimin e autorizimit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës.".

6. Pika 10 shfuqizohet.

7. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"11. Afati i vlefshmërisë së autorizimit të posaçëm për mbajtje arme bazohet në vlerësimin e ekzistencës së kërcënimit dhe rrezikut për jetën, vlerësim i cili kryhet të paktën çdo 1 (një) vit.".

8. Pas pikës 11 shtohen pikat 11/1 dhe 11/2, me këtë përmbajtje:

"11/1 3 (tre) muaj përpara përfundimit të afatit të autorizimit të posaçëm, shtetasi ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rivlerësimin e ekzistencës së kërcënimit dhe rrezikut për jetën, me qëllim rinovimin e autorizimit. Për rinovimin e autorizimit shtetasi duhet të ndjekë të njëjtat procedura, si në rastin e pajisjes me autorizim të posaçëm, për herë të parë.

11/2 Në rast se Komisioni nuk vendos për rinovimin e autorizimit të posaçëm, në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", të ndryshuar, personit i pushon vetiu e drejta për mbajtjen e armës dhe detyrohet që, brenda 3 (tri) ditëve, ta dorëzojë në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit që ka për detyrë administrimin e armës.

Pas dorëzimit të armës në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit, që ka për detyrë administrimin e armës, personi ka të drejtë:

a) të ndjekë procedurën për tjetërsimin (shitjen) e armës sipas nenit 39, të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", të ndryshuar;

b) të kërkojë autorizim për mbajtje arme në vendbanim. Në këtë rast ndiqen procedurat, rregullat dhe afatet për vlerësimin e përmbushjes së kritereve, për pajisjen me autorizim, për mbajtje arme në vendbanim.".

9. Pika 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"16. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 291, datë 19.5.2021

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2021, PËR MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "PËRMIRËSIMI I MODULIT TË MENAXHIMIT TË KONTROLLIT TË FATURIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", llogaria ekonomike 231, në programin buxhetor 01140 "Menaxhimi i të ardhurave tatimore", i shtohet fondi prej 220 858 088 (dyqind e njëzet milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë e tetë) lekësh, për projektin "Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit".

2. Efekti financiar, i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 299, datë 19.5.2021

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. GEROND HUSI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 20, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Gerond Husi, në masën 3 000 000 (tre milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 300, datë 19.5.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 20, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2021"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 5, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca nr. 2, bashkëlidhur vendimit nr. 20, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për spitalet, për vitin 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA NR. 2

BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2021

Institucionet	(Buxheti në 000 lekë sipas artikujve)						Totali
	Art. 600	Art. 601	art. 602	Art. 602 PPP laboratorë	Art. 604	Rezervë	
BERAT	322,000	50,700	170,000	16,760			559,460
BULQIZË	81,750	13,520	30,000				125,270
DELVINË	37,500	6,110	6,500				50,110
DEVOLL	53,100	8,770	10,000				71,870
DIBËR	277,900	44,970	115,000				437,870
ELBASAN	477,400	77,270	244,750	39,663			839,083
FIER	434,500	70,250	266,750	33,402			804,902
GRAMSH	131,700	20,570	37,000				189,270
GJIROKASTËR	237,600	37,650	94,000				369,250
HAS	53,400	7,850	13,000				74,250
KAVAJË	124,900	20,350	30,000				175,250
KOLONJË	89,750	14,750	20,000				124,500
KORÇË	496,200	73,900	206,000	31,725			807,825
KRUJË	156,100	21,630	26,000				203,730
KUÇOVË	74,500	11,300	15,000				100,800
KUKËS	293,000	44,500	108,000	23,674			469,174
KURBIN	94,580	14,830	30,000				139,410
LEZHË	283,000	44,800	122,000	13,070			462,870
LIBRAZHD	156,800	25,900	51,000				233,700
LUSHNJË	253,500	40,400	100,000	8,806			402,706
MALËSI E MADHE	23,800	3,930	6,000				33,730
MALLAKASTËR	63,300	10,300	13,000				86,600
MAT	138,500	22,400	36,000				196,900
MIRDITË	114,300	17,900	27,000				159,200
PEQIN	38,000	6,300	5,500				49,800
PËRMET	84,800	14,100	35,000				133,900
POGRADEC	184,000	29,500	77,000				290,500
PUKË	105,500	16,050	35,000				156,550
SARANDË	172,000	26,400	100,000	6,443			304,843
SKRAPAR	89,150	14,700	16,000				119,850
SHKODËR	604,000	96,050	215,000	14,015			929,065
TEPELENË	95,600	15,300	16,000				126,900
QSUT	2,785,700	416,250	3,831,200	220,167			7,253,317
SUOGJ "MBRETËRESHA GERALDINË"	318,100	50,700	280,000	28,000			676,800
SUOGJ "KOÇO GLIOZHENI"	256,700	42,100	216,000	28,000			542,800
SU "SHEFQET NDROQI"	625,700	62,100	478,000	3,647			1,169,447
SU TRAUMA	172,900	23,100	180,000	33,289			409,289
TROPOJË	111,700	18,300	32,000				162,000
VLORË	455,600	73,800	314,750	8,000			852,150
DURRËS				45,000			45,000
Paketat e shërbimeve					2,037,880		2,037,880
Transferta për individët (mjekë specialistë)					30,000		30,000
Trajtime me VKM					30,000		30,000
Pagesa të shërbimeve PPP					2,483,982		2,483,982
Rezervë				726,783		681,581	1,408,364
Totali	**10,568,530**	**1,609,300**	**7,608,450**	**1,280,444**	**4,581,862**	**681,581**	**26,330,167**

KËRKESË
Nr. 71/5, datë 18.5.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimet shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti *"Zgjerimi territorial i varrezave të qytetit të Durrësit"*.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Durrës.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Durrës, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 17,543,430 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet e tre mijë e katërqind e tridhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI TERRITORIAL I VARREZAVE TË QYTETIT TË DURRËSIT"

Nr.	Emër atësi mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloj i pasurisë	Sip. totale /m²	Sip. e shpronësuar/ m²	Çmimi në lekë /m²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Dafina Musli Driza	1574	113/6	vresht	3700	3700	397	**1,468,900**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
2	Banush Berberi	1574	113/8	ullishte	2947	2947	397	**1,169,959**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
3	Margarita Mihal Kondakçi	1574	113/9	ullishte	683	683	397	**271,151**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
4	Laz Mihal Berberi	1574	115/3	ullishte	2947	2947	397	**1,169,959**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
5	Jorgji Mihal Berberi	1574	115/4	ullishte	2947	2947	397	**1,169,959**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
6	Sotir Mihal Berberi	1574	115/5	ullishte	2947	2947	397	**1,169,959**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
7	Margarita Mihal Kondakçi	1574	115/6	ullishte	1459	1459	397	**579,223**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
8	Lina Çerma	1574	115/7	arë	2440	2440	397	**968,680**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
9	Marjana Driza	1574	115/8	arë	2440	2440	397	**968,680**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
10	Miltiadh Berberi	1574	115/9	arë	1520	1520	397	**603,440**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
11	Andrea Berberi	1574	116/1	arë	2440	2440	397	**968,680**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
12	Bashkëpronësi të: Lina Cerma Andrea Berberi Marjana Driza Miltiadh Berberi	1574	116/2	arë	2440	2440	397	**968,680**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
13	Miltiadh Berberi	1574	116/3	arë	920	920	397	**365,240**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
14	Miltiadh Vangjel Berberi	1574	120	arë	3100	3100	397	**1,230,700**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
15	Bashkëpronësi të: Lirije Baci Petrit Hoxha Pranvera Hoxha	1574	138/12	arë	4000	4000	397	**1,588,000**	Konfirmuar nga DVASHK-ja

	Rakip Hoxha								
	Avni Hoxha								
	Suad Hoxha								
	Kremlina Hoxha (Tati)								
	Teuta Hoxha								
	Lindita Hoxha (Dhora)								
	Artan Hoxha								
16	Astrit Vesel Doka	1574	138/6	vresht	4000	4000	397	**1,588,000**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
17	Sherif Sula	1574	138/14	vresht	1000	1000	397	**397,000**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
18	Murat Sharka	1574	138/15	vresht	2260	2260	397	**897,220**	Konfirmuar nga DVASHK-ja
	Vlera totale				**44,190.0**	**44,190**		**17'543'430**	

Shënim.

1. Për tokën "arë", çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 76
Datë: 2021/05/21 12:48:23
f940ce8f-0359-4252-a636-8269fcf3a0c6

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë